



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe  
Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 16 shkurt 2022

**Language:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim në lidhje me Kërkesën për Seancë Gjyqësore**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup  
Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenet 39(1) dhe (13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), merr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 3 dhjetor 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi parashtrimet e veta lidhur me trajtimin e informacionit dhe të kontakteve konfidenciale me dëshmitarët (“Parashtrimet e ZPS-së”).<sup>2</sup>
2. Më 10 dhjetor 2021, mbrojtësi i viktimave iu përgjigj Parashtrimeve të ZPS-së (“Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave”).<sup>3</sup>
3. Më 15 dhjetor 2021, Mbrojtja e Hashim Thaçit, Rexhep Selimit, Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit (përkatësisht “Mbrojtja e Thaçit”, “Mbrojtja e Selimit”, “Mbrojtja e Krasniqit” dhe “Mbrojtja e Veselit”, dhe bashkërisht “Ekipet e Mbrojtjes”) iu përgjigjën Parashtrimeve të ZPS-së (“Përgjigjet e Mbrojtjes”).<sup>4</sup>
4. Më 21 janar 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, duke pasur parasysh faktin se propozimet e ZPS-së parashikojnë një rol të gjerë për Zyrën Administrative dhe se Përgjigjet e Mbrojtjes e trajtojnë gjerësisht përfshirjen e propozuar të Zyrës Administrative, urdhëroi Zyrën Administrative që jo më vonë se data 4 shkurt 2022 të

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00594, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Informacionin dhe Kontaktet Konfidenciale me Dëshmitarë*, 3 dhjetor 2021, publike.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, F00605, Mbrojtësi i Viktimave, *Përgjigje e Mbrojtësit të Viktimave ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin dhe Kontaktet Konfidenciale me Dëshmitarë*, 10 dhjetor 2021, publike.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00625, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin dhe Kontaktet Konfidenciale me Dëshmitarë*, 15 dhjetor 2021, publike (“Përgjigjja e Thaçit”); F00626, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin dhe Kontaktet Konfidenciale me Dëshmitarë*, 15 dhjetor 2021, publike; F00627, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin dhe Kontaktet Konfidenciale me Dëshmitarë*, 15 dhjetor 2021, konfidenciale (një version i redaktuar publik u parashtrua më 17 dhjetor 2021, F00627/RED); F00628, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin dhe Kontaktet Konfidenciale me Dëshmitarë*, 15 dhjetor 2021, publike.

dorëzonte parashtrime në lidhje me çdo temë të dalë nga Parashtrimet e ZPS-së, nga Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave dhe/ose nga Përgjigjet e Mbrojtjes (“Urdhri i 21 janarit 2022”).<sup>5</sup>

5. Më 3 shkurt 2022, Zyra Administrative dorëzoi parashtrimet e veta në përputhje me Urdhrin e 21 janarit 2022 (“Parashtrimet e Zyrës Administrative”).<sup>6</sup>

6. Më 14 shkurt 2022, mbrojtësi i viktimave,<sup>7</sup> ZPS-ja,<sup>8</sup> dhe Ekipet e Mbrojtjes<sup>9</sup> iu përgjigjën Parashtrimeve të Zyrës Administrative në përputhje me Urdhrin e 21 janarit 2022.

## II. PARASHTRIMET

7. Mbrojtja e Thaçit kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të caktojë një seancë gjyqësore për paraqitjen e argumenteve lidhur me temat e ngritura nga Parashtrimet e ZPS-së, pasi këto janë tema thelbësore për hetimet e Mbrojtjes, të cilat nuk duhen

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, F00650, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër drejtuar Administratores për Parashtrime*, 21 janar 2022, publik, para. 5-7.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, F00679, Administratorja, *Parashtrime të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarët*, 3 shkurt 2022, konfidencial.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-06, F00690, Mbrojtësi i Viktimave, *Parashtrime të Mëtejshme nga Mbrojtësi i Viktimave në lidhje me Kornizën e ZPS-së për Trajtimin e Informacionit dhe Kontakteve Konfidenciale dhe me Dëshmitarët gjatë Hetimeve* 14 shkurt 2022, publik. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Thaçit kërkon që këto parashtrime të fshihen nga dokumentacioni, *shih* KSC-BC-2020-06, F00697, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimeve të Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave në lidhje me Kornizën e ZPS-së për Trajtimin e Informacionit dhe Kontakteve Konfidenciale dhe me Dëshmitarët gjatë Hetimeve*, 15 shkurt 2022, publik, para. 1, 18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit nuk ndikon në këtë vendim, përfshirë kryerjen e seancës gjyqësore që po merret në shqyrtim, dhe do të trajtohet në kohën e duhur.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-06, F00693, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarët*, 14 shkurt 2022, konfidencial.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-06, F00691, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarët*, 14 shkurt 2022, konfidenciale; F00692, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarët*, 14 shkurt 2022, publike; F00694, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarët* 14 shkurt 2022, publike; F00695, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarët*, 14 shkurt 2022, konfidenciale.

trajtuar përmes parashtrimesh të kufizuara me shkrim, sidomos meqenëse masat e vendosura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake me gjasë do të mbeten në fuqi gjatë gjykimit ("Kërkesa").<sup>10</sup> Mbrojtja e Veselit, Mbrojtja e Selimit dhe Mbrojtja e Krasniqit e mbështesin Kërkesën.<sup>11</sup>

8. ZPS-ja argumenton se tashmë janë bërë parashtrime me shkrim dhe palët kanë mundësinë që të përgjigjen më tej duke mbajtur parasysh Parashtrimet e Zyrës Administrative.<sup>12</sup> Mbrojtësi i viktimave është neutral nëse duhen paraqitur parashtrime të mëtejshme me gojë ose me shkrim.<sup>13</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Në bazë të nenit 39(1) dhe (13) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka, ndër të tjera, kompetencë që të nxjerrë çdo urdhër apo vendim të nevojshëm për të siguruar që çështja të përgatitet siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim.

### IV. DISKUTIM

10. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, edhe pse në bazë të Ligjit dhe Rregullores së Procedurës dhe Provave përpara Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullores")<sup>14</sup> mbajtja e seancës gjyqësore për temat e ngritura nga Parashtrimet e ZPS-së nuk është e detyrueshme, këto tema: (i) nuk janë shqyrtuar më parë prej Dhomave të Specializuara në kontekstin e procedurës paraprake; dhe (ii) kërkojnë

---

<sup>10</sup> Përgjigjja e Thaçit, para. 4, 42, 43; KSC-BC-2020-06, Transkript, 4 shkurt 2022, publik, f. 861, rreshti 7-15; Përgjigjja e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimeve të Zyrës Administrative, para. 1, 12-15.

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript, 4 shkurt 2022, publik, f. 862, rreshti 23-24, f. 863, rreshti 15-21, f. 864, rreshti 2-3; Përgjigjja e Mbrojtjes së Veselit ndaj Parashtrimeve të Zyrës Administrative, para. 16-17.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript, 4 shkurt 2022, publik, f. 864, rreshti 9-12.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript, 4 shkurt 2022, publik, f. 864, rreshti 19-20.

<sup>14</sup> *Shih për shembull* KSC-BC-2020-06, F00178, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm të Kadri Veselit*, 22 janar 2021, publik, para. 62; F00150, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kryerjen e Rishikimit të Paraburgimit dhe Ndryshimin e Afatit për Mocionet Paraprake*, 16 dhjetor 2020, publik, para. 18.

analizë të kujdesshme duke marrë parasysh argumentet në parashtrimet me shkrim të palëve dhe pjesëmarrësve, përfshirë argumentet e ngritura nga Ekipet e Mbrojtjes në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë. Për më tepër, në përgjigjen e ZPS për Parashtrimet e Zyrës Administrative, ZPS-ja propozon ndryshime të propozimeve të paraqitura në Parashtrimet e ZPS-së, dhe Ekipet e Mbrojtjes e mbrojtësi i viktimave nuk kanë pasur mundësi që të shprehin pikëpamjet e tyre për këto propozime.

11. Në këto rrethana konkrete, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton Kërkesën dhe thërret një seancë gjyqësore ditën e martë, 22 shkurt 2022. Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron palët dhe pjesëmarrësit që, nëse është e zbatueshme dhe në qoftë se nuk i kanë trajtuar në parashtrimet e tyre me shkrim, të trajtojnë këto tema:

- (i) cila është baza ligjore konkrete për propozimet e paraqitura në Parashtrimet e ZPS-së dhe, në veçanti, a bazohen këto propozime ekskluzivisht në rregullën 80 të Rregullores;
- (ii) a duhet që propozimet e paraqitura në Parashtrimet e ZPS-së lidhur me kontaktet me dëshmitarët të zbatohen për të gjithë dëshmitarët e përfshirë në listën e dëshmitarëve të ZPS-së, apo vetëm për kategori të veçanta të dëshmitarëve (siç janë dëshmitarët për të cilët janë urdhëruar masa mbrojtëse - për shembull dëshmitarët për të cilët është autorizuar shtyrja e nxjerrjes së identiteteve të tyre deri 30 ditë përpara dëshmisë së tyre - ose dëshmitarët që posaçërisht kanë bërë të ditur se dëshirojnë zbatimin e këtyre masave) dhe a kërkohen masa të posaçme për dëshmitarët me status të dyfishtë;
- (iii) cili është pozicioni i ZPS-së në lidhje me argumentet në Përgjigjet e Mbrojtjes lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë;
- (iv) a synojnë Ekipet e Mbrojtjes organizimin e intervistave të përbashkëta me dëshmitarët e përfshirë në listën e dëshmitarëve të ZPS-së;
- (v) a mundet Zyra Administrative, duke pasur parasysh përgjigjet ndaj Parashtrimeve të Zyrës Administrative, që të ofrojë informacion më specifik për

pasojat e përfshirjes së propozuar të saj në lidhje me propozimet e paraqitura në Parashtrimet e ZPS-së që kanë të bëjnë me kontaktet me dëshmitarë të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë;<sup>15</sup>

(vi) cili është pozicioni i Ekipeve të Mbrojtjes, i mbrojtësit të viktimave dhe i Zyrës Administrative ndaj propozimeve të ndryshuara të paraqitura në Përgjigjen e ZPS-së ndaj Parashtrimeve të Zyrës Administrative;

(vii) a mbajnë parasysh palët dhe pjesëmarrësit që modeli i zhvilluar në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për temat që janë objekt shqyrtimi ose ndonjë model tjetër i zhvilluar tek një gjykatë tjetër ndërkombëtare ose e ndërkombëtarizuar, mund të zbatohet në Dhomat e Specializuara; dhe

(viii) a mund të kryhen diskutime *inter partes* dhe, nëse po, a mundet që këto diskutime të përfundojnë jo më vonë se data 31 mars 2022.

12. Gjithashtu, duke pasur parasysh se seanca gjyqësore nuk përbën mundësi për palët dhe pjesëmarrësit që të përsërisin argumentet e paraqitura në parashtrimet me shkrim ose të shtjellojnë tema që nuk lidhen me temat që janë objekt shqyrtimi, secila palë ose pjesëmarrës lejohet që të paraqesë parashtrime për çfarëdo teme tjetër që del drejtpërdrejtë nga Parashtrimet e ZPS-së në qoftë se këto tema nuk janë trajtuar më parë. Secila palë dhe pjesëmarrës ka në dispozicion deri në 15 minuta për të paraqitur argumentet e veta, duke përjashtuar kohën e nevojshme për t'iu përgjigjur pyetjeve të bëra nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

13. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, edhe pse Parashtrimet e Zyrës Administrative klasifikohen si konfidenciale, mbrojtësi i viktimave, Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Veselit kanë dorëzuar përgjigje publike ndaj Parashtrimeve të Zyrës Administrative. Edhe pse këto përgjigje nuk zbulojnë informacion konfidencial, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u kujton palëve dhe pjesëmarrësve se, sipas rregullës 82(4) të Rregullores, çdo përgjigje, kundërpërgjigje ose parashtrim tjetër që

---

<sup>15</sup> Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 10-11.

lidhet me parashtrimin fillestar ka të njëjtin klasifikim, përveç nëse paneli vendos ndryshe.

## V. VENDIM

14. Për arsyet e përmendura më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

a) **MIRATON** Kërkesën dhe thërret një seancë gjyqësore **ditën e martë, 22 shkurt 2022** nga ora 14:30 deri në orën 18:00 sipas kushteve të identifikuara në këtë vendim;

b) **URDHËRON** Administratoren dhe Mbrojtjen e Krasniqit që të parashtrojnë versione të redaktuara publike, përkatësisht të Parashtrimeve të Zyrës Administrative (F00679) dhe të Përgjigjes së Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimeve të Zyrës Administrative (F00695), ose të bëjnë të ditur se këto parashtrime mund të riklasifikohen si publike, jo më vonë se **ditën e hënë, 21 shkurt 2022**; dhe

**URDHËRON Administratoren** që të riklasifikojë si publike Përgjigjen e Mbrojtjes së Selimit ndaj Parashtrimeve të Zyrës Administrative (F00691) dhe Përgjigjen e ZPS-së ndaj Parashtrimeve të Zyrës Administrative (F00693).

\_\_\_\_\_  
/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

E mërkurë, 16 shkurt 2022

Në Hagë, Holandë.